



Funded by  
the European Union



Promoting Universal  
Access to **Clean Water**

**PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE #3**

# **Siguria e Ujit të Pijshëm në Kosovë**



Let's do it  Peja!



## **SQARIM**

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e projektit “Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër”, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Let’s Do It Peja. Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.



PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE

# **Siguria e Ujit të Pijshëm në Kosovë**

Gusht 2023



# PËRMBAJTJA

<i>LISTA E FIGURAVE.....</i>	<i>v</i>
<i>SHKURTESAT.....</i>	<i>vi</i>
<i>HYRJE – SIGURIA E UJIT .....</i>	<i>1</i>
<i>ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE .....</i>	<i>2</i>
<i>GJENDJA AKTUALE DHE SFIDAT .....</i>	<i>4</i>
<i>1. Siguria e ujit që furnizohet nga sistemet publike të ujësjellësit të cilat menaxhohen nga KRU-të. 5</i>	
<i>2. Siguria e ujit që furnizohet nga sistemet e ujësjellësit të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të.....</i>	<i>6</i>
<i>3. Siguria e ujit që furnizohet nga burimet individuale të ujit (puset, etj.).....</i>	<i>7</i>
<i>POLITIKA E REKOMANDUAR.....</i>	<i>8</i>
<i>REFERENCAT .....</i>	<i>10</i>

# LISTA E FIGURAVE

<i>Figura 1. Uji i pijes .....</i>	<i>1</i>
<i>Figura 2. Logoja e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK).....</i>	<i>3</i>
<i>Figura 3. Ikona e SDG 6.....</i>	<i>4</i>
<i>Figura 4. Një nga 7 kompanitë rajonale për furnizim me ujë të pijshëm në Kosovë.....</i>	<i>5</i>
<i>Figura 5. Pus i ujit në fshatin Polac, Skënderaj.....</i>	<i>7</i>



# SHKURTESAT

<b>ARRU</b>	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
<b>IKSHP</b>	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
<b>KRU</b>	Kompania Rajonale e Ujit
<b>MMPHI</b>	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>SHUKOS</b>	Shoqata e Ujësjetësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ

# HYRJE - SIGURIA E UJIT

Uji është esencjal për jetën. Siguria dhe cilësia e ujit janë me rëndësi fundamentale për zhvillimin dhe mirëqenien e njerëzve. Sigurimi i qasjes në ujë të pastër dhe të sigurt është një prej mjeteve më efektive në promovimin e shëndetit dhe reduktimin e varfërisë. Rrjedhimisht, furnizimi me ujë të mjaftueshëm, të sigurt dhe qasja në të duhet të u mundësohet të gjithëve.

Përmirësimi i qasjes në ujë të sigurt për pije ofron përfitime të shumta shëndetësore. Kjo për shkak të rëndësisë së ujit për mbajtjen e higjienës dhe në anën tjetër për shkak se shumë sëmundje janë rezultat i kontaminimit të ujit të pijshëm të cilat paraqesin problem të theksuar për shëndetin e njeriut. Kategoritë më të rrezikuara nga këto lloj sëmundjesh janë foshnjat, fëmijët dhe pleqtë.



*Figura 1. Uji i pijes*

Furnizimi me ujë të pijshëm bëhet në forma të ndryshme: nga sistemet publike të ujësjellësit që menaxhohen nga kompanitë publike (KRU-të), nga sistemet rurale të ujësjellësit që nuk menaxhohen nga kompanitë publike, nga sistemet individuale (puse, burime, etj.).

**Uji i sigurt për pije është ai ujë i cili nuk paraqet kurrfarë rreziku për shëndetin edhe kur konsumohet gjatë gjithë jetës.**

Furnizimi me ujë përballet me rreziqe të shumta, që shkaktojnë probleme të konsiderueshme për sisteme të mëdha dhe të vogla të furnizimit me ujë. Ndër këto rreziqe janë ndotja me patogjene, ndotja me produkte kimike të bujqësisë, paraqitja e algave si rezultat i temperaturave të larta dhe eutrofikimi. Ky i fundit – eutrofikimi – është realisht ‘plakja’ e një ekosistemi akuatik siç është liqeni, që vjen si rezultat i rritjes së koncentrimin të materieve organike (fosforit dhe azotit), e që manifestohet me paraqitjen e algave dhe organizmave mikroskopikë në sipërfaqen e ujit gjë që pengon depërtimin e dritës së diellit dhe absorbimin e oksigjenit në ujë.

Identifikimi dhe menaxhimi i këtyre rreziqeve janë me rëndësi të jashtëzakonshme për të parandaluar dhe zbutur pasojat negative nga këto kërcënime.

Cilësia dhe siguria e ujit të pijshëm që furnizohet përmes sistemeve publike të ujësjellësit të cilat menaxhohen nga Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të) është në përgjithësi e mirë. Kështu, në vitin 2021, shumica dërmuese e mostrave të analizuara (99.16% në përputhshmëri me

vlerat parametrike mikrobiologjike, ndërkaq 98.42% në përputhshmëri me vlerat parametrike kimike) në sistemet e ujësjellësit të cilat menaxhohen nga KRU-të kanë qenë në pajtim me standardet e cilësisë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi<sup>1</sup>, njësoj sikurse edhe në vitet paraprake (në vitin 2021–98.1%, në vitin 2020 ishte 99.4%, në vitin 2019 ishte 98.8% etj.)<sup>2</sup>

Megjithatë, në disa komuna (si p.sh. komuna e Klinës<sup>3</sup>) dhe në disa raste (siç ishte rasti në disa fshatra të komunës së Deçanit<sup>4</sup> (Prilep, Irzniq, Glllogjan, Gramaqel, Baballoq, Rastavice), në korrik 2021) ka pasur probleme sa i përket cilësisë dhe sigurisë së ujit të pijshëm. Në veçanti, problemet më të mëdha sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm janë në rastet e sistemeve të ujësjellësit të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të dhe në rastet e puseve individuale.

## ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Korniza ligjore dhe institucionale për cilësinë e ujit të pijshëm në Kosovë është mjaft mirë e konsoliduar.

Korniza ligjore për *cilësinë e ujit të pijshëm* është përcaktuar me [Ligjin Nr. 2/L-78 për Shëndetësi Publike](#) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2008 dhe aktin nënligjor ([Udhëzimin Administrativ \(UA\) Nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor](#)) të miratuar nga qeveria në vitin 2021, i cili në përputhje me këtë ligj përbëjnë legjislacionin me të cilin rregullohet cilësia e ujit në Kosovë. Ky UA e ka transpozuar në tërësi direktivën përkatëse të BE-së për cilësinë e ujit të pijshëm<sup>5</sup>.

Legjislacioni relevant për *mbrojtjen e burimeve të ujit* që përdoren për furnizim me ujë, ndërkaq, konsiston në [Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës](#) dhe akti nënligjor ([Udhëzimi Administrativ \(UA\) Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit](#)) i nxjerrë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vitin 2017.

---

<sup>1</sup> Sipas *RAPORTIT VJETOR TË DEPARTAMENTIT TË EKOLOGJISË HUMANE PËR VITIN 2022*. Ministria e Shëndetësisë, Shkurt 2023.

<sup>2</sup> Bazuar në *Raportet Vjetore të Performancës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit* për vitet 2021, 2020, 2019, të publikuara nga Autoriteti për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (ARRU). Marrë nga: <http://www.arru-rks.org/monitorimi/374/raportet-vjetore-te-performances/374>

<sup>3</sup> [Raporti-vjetor-Cilesia-e-ujit-te-pijshem-ne-Kosove-2017.pdf \(niph-rks.org\)](#) publikuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, qershor 2017.

<sup>4</sup> [Raporti Vjetor i Performancës së Ofruesve të Shërbimit për vitin 2021](#) i publikuar nga ARRU.

<sup>5</sup> Directive (EU) 2020/2184 of the European Parliament and of the Council **on the quality of water intended for human consumption**, of 16 December 2020. Marrë nga: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32020L2184&qid=1692617446411>.

Me Ligjin për Shëndetësinë Publike është përcaktuar roli kyç i [Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike](#) (IKSHP) për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm si autoritet përgjegjës që kryen *analizimin dhe vlerësimin* e cilësisë si dhe për *mbikëqyrjen dhe kontrollin e ujit të pijshëm*.



*Figura 2. Logoja e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)*

Në anën tjetër, me UA për cilësinë e ujit të pijshëm rregullohen në mënyrë më të detajuar të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me cilësinë e ujit të pijshëm, përfshirë vlerat parametrike të cilësisë të cilat duhet t`i përmbushë uji i cili përdoret për pije dhe gatim, modalitetet e monitorimit të cilësisë së ujit, veprimet që duhet të ndërmerren në rast të rrezikimit të cilësisë së ujit të pijshëm si dhe përgjegjësitë institucionale për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Me këtë UA është përcaktuar që uji i pijshëm duhet të jetë i shëndetshëm dhe i pastër, që nënkupton, se ai:

- (i) nuk duhet të përmbajë asnjë mikroorganizëm ose parazit dhe asnjë substancë tjetër që mund të përbëjë rrezik potencial për shëndetin e njeriut, dhe
- (ii) t`i përmbushë kërkesat minimale sa i përket cilësisë mikrobiologjike dhe fiziko-kimike të përcaktuara me këtë UA.

Me këtë UA është përcaktuar obligimi i furnizuesve të ujit (KRU–ve) që të hartojnë *planet e sigurisë së ujit*. Këto plane duhet të hartohen duke bazuar në parimin e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut dhe në udhëzuesin të cilin e përgatit IKSHP. Përgjegjësitë ligjore në lidhje me cilësinë e ujit të pijshëm IKSHP i zbaton përmes Qendrës së Ujit që është si njësi në kuadër të IKSHP. Qendra e Ujit, sipas UA për cilësinë e ujit të pijshëm, është përgjegjëse për ndërmarrjen e masave të nevojshme për të siguruar që uji i pijshëm të jetë i shëndetshëm dhe i pastër.

Kontrollin dhe mbikëqyrjen e cilësisë së ujit të pijshëm IKSHP e realizon përmes *monitorimit të përputhshmërisë* që përfshin të gjitha masat me të cilat verifikohet se uji që iu furnizohet

konsumatorëve i përmbush vlerat parametrike të përcaktuara. Kur uji i pijshëm nuk i përmbush vlerat parametrike të cilësisë, Qendra e Ujit e IKSHP duhet t`i njoftojë autoritetet përkatëse (komunat, Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit) dhe furnizuesin e ujit për mospërputhjen e ujit me vlerat parametrike si dhe të vendosë dhe t`iu rekomandojë furnizuesve të ujit dhe autoriteteve përkatëse veprime korigjuese, përfshirë kufizimet e mundshme të përdorimit të ujit që nevojiten për të mbrojtur shëndetin e njeriut.

Monitorimi i parametrave radioaktiv (Radoni, Tritiumi dhe Doza Indikative) sipas UA për cilësinë e ujit të pijshëm është përgjegjësi e [Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore \(AMRRSB\)](#), e cila tash funksionon në kuadër të MMPHI. Monitorimi i këtyre parametrave është praktikë edhe në vendet e BE-së dhe është i rregulluar me direktivat përkatëse të BE-së për cilësinë e ujit të pijshëm me qëllim që të bëhet vlerësimi nëse prania e substancave radioaktive në ujin e destinuar për konsum njerëzor paraqet rrezik për shëndetin e njeriut, i cili kërkon veprim dhe, kur është e nevojshme, ndërmarrjen e veprimeve korigjuese për përmirësimin e cilësisë së ujit në nivel që është në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

## GJENDJA AKTUALE DHE SFIDAT

Uji i cilësisë së duhur është indikator bazë për shëndetin dhe mirëqenien e një shoqërie dhe rrjedhimisht me rëndësi thelbësore për zhvillimin e një vendi. Uji i ndotur jo vetëm që paraqet kërcënim të menjëhershëm për shëndetin e njeriut por gjithashtu ka ndikim edhe në shkallën e produktivitetit të një individi dhe kështu në performancën e përgjithshme të shoqërisë.

Me [Agjendën 2030 të OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm](#), të cilën e ka miratuar edhe Kosova në vitin 2018, janë përcaktuar 17 synime të zhvillimit të qëndrueshëm. Në [synimin 6 \(SDG 6\)](#) të këtij dokumenti thuhet: *“uji e mirëmban jetën, por uji i pastër dhe i sigurt e përkufizon civilizimin”*. Caku i parë në kuadër të këtij synimi (Caku 6.1) është: *“Deri në vitin 2030 të arrihet qasje universale dhe e drejtë në ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë”*.



Figura 3. Ikona e SDG 6

Aktualisht në Kosovë mbi 90% e popullsisë furnizohen me ujë nga sistemet publike të ujësjellësit. Nga ky numër, 79%<sup>6</sup> furnizohen nga sistemet publike të ujësjellësit që menaxhohen nga KRU-të, ndërsa të tjerët nga sisteme publike të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të (këto sisteme 'menaxhohen' nga komuniteti). Pjesa tjetër e popullsisë prej rreth 4%, furnizohen me ujë nga burime individuale (puse).

Vlerësohet se në vitin 2020 rreth 76%<sup>7</sup> e popullsisë në botë janë furnizuar me ujë të pijshëm i cili menaxhohet në mënyrë të sigurt.

## 1. Siguria e ujit që furnizohet nga sistemet publike të ujësjellësit të cilat menaxhohen nga KRU-të

Shumica e sistemeve publike të ujësjellësit përmes të cilave furnizohen pjesa dërmuese e popullsisë së Kosovës (79%, sipas ARRU) menaxhohen nga shtatë KRU-të. Cilësia e ujit që furnizohet përmes këtyre sistemeve kontrollohet nga furnizuesi i ujit (KRU respektive) si dhe nga IKSHP. Vlen të ritheksohet që sipas raporteve të IKSHP, në 6-7 vitet e fundit, mbi 98% e mostrave të kontrolluara janë në përputhje me vlerat parametrike të përcaktuara me ligj.



Figura 4. Një nga 7 kompanitë rajonale për furnizim me ujë të pijshëm në Kosovë

Për më tepër, me qëllim që të arrihet siguria e ujit të pijshëm, me legjislacion kërkohet që furnizuesit e ujit (KRU-të respektive) të hartojnë *planet e sigurisë së ujit* duke u bazuar në parimet e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut për të gjithë komponentët në zinxhirin e furnizimit me ujë, duke filluar nga burimi i ujit deri te rubineti i konsumatorit. Kjo qasje për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm përmes planeve të sigurisë së ujit, është një qasje

<sup>6</sup> Sipas *Raportit Vjetor të Performancës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit për vitin 2021*, të hartuar dhe publikuar nga ARRU –

[http://www.arru-rks.org/assets/cms/upload/RaportiVjetoriPerformancesOfruesveteSherbimit\\_05.09.2022.pdf](http://www.arru-rks.org/assets/cms/upload/RaportiVjetoriPerformancesOfruesveteSherbimit_05.09.2022.pdf)

<sup>7</sup> Sipas raportit të OBSH: *State of the World's Drinking Water: An urgent call to action to accelerate progress on ensuring safe drinking water for all* – <https://www.who.int/publications/i/item/9789240060807>

universale që sot zbatohet pothuajse në tërë botën dhe rekomandohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh). KRU-të përmes Shoqatës për Kompanitë e Ujit dhe Kanalizimit (SHUKOS) tashmë kanë filluar punën në hartimin e planeve të sigurisë së ujit, të cilat duhet t'i përfundojnë deri në fund të vitit 2025.

Si përfundim, siguria e ujit të pijshëm i cili furnizohet përmes sistemeve të ujësjellësit të cilët menaxhohen nga KRU-të është **në shkallë të kënaqshme** duke pasur se:

- Uji që furnizohet përmes këtyre sistemeve, *trajtohet dhe kontrollohet nga furnizuesi i ujit* si dhe *mbikëqyret nga IKSHP*. Rezultatet e monitorimit tregojnë se cilësia e këtij uji është e mirë – ka shkallë të lartë (mbi 98%) të përputhshmërisë me vlerat parametrike të cilësisë;
- Burimet e ujit prej nga furnizohen këto sisteme i kanë të përcaktuara *zonat sanitare të mbrojtjes* në të cilat zbatohen masa ndaluese dhe kufizuese në pajtim me ligjin, me qëllim që të mbrohet burimi nga ndotja;
- Furnizuesit e ujit (KRU-të) janë në proces të *hartimit të planeve të sigurisë së ujit* përmes të cilave adresohen të gjitha subatancat dhe situatat e dëmshme të mundshme (hazardet) që potencialisht mund ta rrezikojnë cilësinë e furnizimit me ujë. Hartimi dhe më pastaj zbatimi i këtyre planeve do të mundësojë arritjen e një shkalle shumë të lartë të sigurisë së ujit.

## **2. Siguria e ujit që furnizohet nga sistemet e ujësjellësit të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të**

Një numër i sistemeve të ujësjellësit nuk janë nën menaxhimin e KRU-ve. Këtu bëhet fjalë për një numër të konsiderueshëm të sistemeve rurale të ujësjellësit, por edhe të disa komunave (p.sh. Parteshi, Shtërpca). Sistemet e ujësjellësit në katër komunat veriore gjithashtu nuk menaxhohen nga KRU-të (menaxhohen nga ndërmarrje komunale të cilat nuk janë të licencuara nga ARRU në pajtim me legjislacionin në fuqi).

Sipas ARRU (raporti vjetor për vitin 2021<sup>8</sup>), një numër i konsiderueshëm i këtyre sistemeve të ujësjellësit, 93 sosh, pritet të merren në menaxhim nga KRU-të.

Uji që furnizohet përmes këtyre sistemeve *nuk kontrollohet nga furnizuesi i ujit* (meqenëse nuk ka një furnizues të ujit të licencuar siç është rasti me KRU-të), dhe *nuk mbikëqyret nga IKSHP*. Për pasojë, nuk ka informacion për cilësinë e ujit që furnizohet nga këto sisteme. Gjithashtu, burimet e ujit nga të cilat furnizohen këto sisteme nuk i kanë të përcaktuara zonat e mbrojtura të burimeve të ujit dhe, rrjedhimisht, nuk zbatohen kurrfarë masa të mbrojtjes së këtyre burimeve që do të duhej të zbatoheshin bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e burimeve të ujit.

---

<sup>8</sup> [Raporti per Nivelin e Sherbimeve 2021.pdf \(arru-rks.org\)](https://www.arru-rks.org)



Si përfundim, siguria e ujit që furnizohet nga sistemet e ujësjellësit të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të **nuk është në nivelin e duhur** meqenëse nuk i nënshtrohet kurrfarë kontrolli dhe mbikëqyrjeje nga institucionet relevante si dhe nuk zbatohen masa mbrojtëse për burimet e ujit nga të cilat furnizohen këto sisteme. Prandaj, problemi i sigurisë së ujit të pijshëm që furnizohet nga këto sisteme të ujësjellësit duhet të adresohet me seriozitetin e duhur nga autoritetet përgjegjëse me qëllim që të parandalohet rrezikimi i shëndetit të popullatës si rezultat i ndotjes së mundshme të ujit të pijshëm që furnizohet nga këto sisteme.

### **3. Siguria e ujit që furnizohet nga burimet individuale të ujit (puset, etj.)**

Pjesa e popullsisë (rreth 4%) që furnizohet nga sistemet individuale të ujësjellësit (puse, burime) është më e cënueshmja sa i përket sigurisë së ujit. Bazuar në deklaratat e shumta publike të IKSHP, shumica e rasteve të sëmundjeve që shkaktohen përmes ujit (si *diarreja*) janë nga zonat që furnizohen nga sistemet individuale të ujësjellësit. Kjo sepse, puset nga furnizohet kjo kategori e popullsisë janë shpeshherë të cekëta dhe për pasojë të pambrojtura nga ndotjet që vijnë nga sipërfaqja e tokës (ndotjet organike dhe inorganike) si dhe nuk kanë pothuajse asnjë masë mbrojtëse që duhet të zbatohen në këto raste.

Uji që furnizohet nga këto sisteme nuk i nënshtrohet kontrollit sistematik nga institucionet përkatëse – përpos kontrollit të rrallë që mund të bëhet me iniciativë të shfrytëzuesit të pusit. Si rrjedhojë, rreziku nga ndotja e ujit të pijshëm në këto raste është pothuajse permanent dhe **siguria e ujit që furnizohet përmes burimeve individuale të ujësjellësit është minimale**. Prandaj, duhet që me prioritet institucionet përgjegjëse të angazhohen në:

- (i) investimin e ndërtimit të sistemeve publike të ujësjellësit në zonat ku nuk ekzistojnë ato, dhe
- (ii) të krijohet një sistem i mbikëqyrjes efektive të kontrollit të cilësisë së ujit në rastet e furnizimit nga puset dhe burimet tjera individuale të ujit dhe zbatimit të standardeve për mbrojtjen e këtyre burimeve (puseve).



*Figura 5. Pus i ujit në fshatin Polac, Skënderaj*



# POLITIKA E REKOMANDUAR

Kosova është e përkushtuar që të arrijë synimet e Agjendës 2030, përfshirë arritjen e cakut 6.1 të synimeve të zhvillimit të qëndrueshëm që nënkupton **sigurimin e qasjes në ujë të pijshëm të sigurt për të gjithë popullatën**. Në anën tjetër, me Strategjinë e rishikuar për Ujëra 2023–2027<sup>9</sup> të miratuar nga Qeveria e Kosovës në maj 2023, ndër objektivat e përcaktuara janë edhe:

- (i) rritja e përputhshmërisë së cilësisë së ujit që furnizohet nga sistemet publike të ujësjellësit – në shkallën 99.5% (nga 98.1% sa është aktualisht) deri në vitin 2027;
- (ii) rritja e mbulueshmërisë së popullatës me sisteme publike të ujësjellësit që menaxhohen nga KRU-të – në shkallën 90% deri në vitin 2027 (nga 79% sa është aktualisht).

Duke pasur këto parasysh, si dhe rëndësinë që ka qasja në ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë si dhe për ekonominë e vendit, rekomandohet që institucionet përgjegjëse të adresojnë problemin e sigurisë së ujërave përmes veprimeve si vijon:

## 1) Hartimi i planeve të sigurisë së ujit nga ana e KRU-ve.

IKSHP duhet ta hartojë një udhëzues që duhet tu shërbejë KRU-ve për hartimin e planeve të sigurisë së ujit për të gjitha sistemet e furnizimit me ujë që ato i menaxhojnë. Për hartimin dhe për zbatimin e këtyre planeve që janë esenciale për sigurinë e ujit, KRU-të duhet të krijojnë ekipet e tyre për hartimin dhe zbatimin e planeve të sigurisë së ujit.

## 2) Mbrojtja efektive e burimeve të ujit të pijshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi<sup>10</sup>.

Meqenëse për shumicë e burimeve të ujit të pijshëm që shfrytëzohen nga KRU-të, prej vitit 2013 e tutje, janë përcaktuar me vendime të Qeverisë zonat sanitare të mbrojtjes bashkë me masat që duhet të zbatohen për secilën prej 3 zonave sanitare, këto masa duhet të zbatohen në tërësi nga KRU-të, MMPHI, dhe komunitetet sipas përgjegjësisë që i ka sipas ligjit.

---

<sup>9</sup> Qeveria e Kosovës (2023). Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimit 2023–2025, Prishtinë – [https://mmpHI.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023\\_d8a77e4b-0cdc-4825-964b-b42d6466fd9e.pdf](https://mmpHI.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023_d8a77e4b-0cdc-4825-964b-b42d6466fd9e.pdf)

<sup>10</sup> [Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës](#) i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në prill të vitit 2013, dhe [Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave Sanitare të Burimeve të Ujit](#) i miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vitin 2017 dhe i ndryshuar dhe plotësuar me [Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 11/22](#).

**3) Integrimi i të gjitha sistemeve urbane dhe rurale të ujësjellësit nën menaxhimin e KRU-ve.**

Duke pasur parasysh që shtatë KRU-të janë ndërmarrje publike të licencuara nga ARRU që kanë kapacitet profesionale dhe financiare për menaxhimin e duhur të sistemeve të ujësjellësit, përfshirë edhe kontrollimin e cilësisë së ujit dhe ofrimin e sigurisë së ujit të pijshëm, është me rëndësi fundamentale që të gjithë sistemet urbane dhe rurale të cilat aktualisht nuk menaxhohen nga KRU-të, të futen nën menaxhimin e tyre. Kjo vlerësohet që është opsioni më i mirë për sigurinë e ujit të pijshëm që furnizohet përmes sistemeve publike të ujësjellësit.

**4) Hartimi i standardeve teknike për ndërtimin dhe mbrojtjen e puseve për furnizim me ujë të objekteve individuale.**

Duke pasur parasysh faktin që ka ende (dhe do të ketë edhe për një kohë) shtëpi që furnizohen me ujë nga puset individuale, rekomandohet që IKSHP ta hartojë një dokument – standardet teknike për gërmimin, shpimin dhe mirëmbajtjen dhe të njëjtin ta zbatojë në praktikë në bashkëpunim me komunat. Gjithashtu, rekomandohet që IKSHP bashkë me komunat ta bëjnë inventarizimin (regjistrimin) e puseve individuale dhe monitorimin e cilësisë së ujit në këto puse duke pasur parasysh përgjegjësinë që ka IKSHP në mbrojtjen e shëndetit publik.

**5) Ndërtimi i sistemeve publike të ujësjellësit në vendbanimet ku nuk ka.**

Duke pasur parasysh problemet që e përcjellin cilësinë e ujit në rastet e furnizimit nga sistemet individuale të ujësjellësit, siç janë: mungesa e kontrollit sistematik të cilësisë së ujit, mungesa e masave për mbrojtjen e burimeve/puseve individuale, duhet që me prioritet të planifikohen dhe të ndërtohen sisteme të ujësjellësit në të gjitha vendbanimet ku mungojnë, si dhe të integrohen ato nën menaxhim të KRU-ve respektive në pajtim me zonat e shërbimit që i kanë ato.

# REFERENCAT

- 1) World Health Organisation (2022). *State of the World`s Drinking Water: An urgent call to action to accelerate progress on ensuring safe drinking water for all.*  
<https://www.who.int/publications/i/item/9789240060807>;
- 2) World Health Organisation (2023). *Water safety plan manual: step-by-step risk management for drinking-water suppliers*, second edition. Geneva; 2023.  
<https://www.who.int/publications/i/item/9789240067691>;
- 3) World Health Organisation (2004). *Guidelines for Drinking-water Quality*, Vol 1, third edition. Geneva.
- 4) Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (2022). Raport Vjetor për Performancën e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit – 2021. Prishtinë.  
[http://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/MonitorimiPerformances/RaportiVjetoriPerformances\\_eOfruesveteSherbimit\\_05.09.2022.pdf](http://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/MonitorimiPerformances/RaportiVjetoriPerformances_eOfruesveteSherbimit_05.09.2022.pdf);
- 5) Agjencia e Statistikave të Kosovës (2022). *Statistikat e Ujërave në Kosovë 2020–2021*. Prishtinë – <https://ask.rks-gov.net/media/6987/statistikat-e-ujrave-2020-2021.pdf>;
- 6) Qeveria e Kosovës (2023). *Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimt 2023–2025*, Prishtinë.  
[https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023\\_d8a77e4b-0cdc-4825-964b-b42d6466fd9e.pdf](https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DocumentsFiles/2023_d8a77e4b-0cdc-4825-964b-b42d6466fd9e.pdf).
- 7) [Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës \(2018\). Raporti-vjetor-Cilësia-e-ujit-të-pijshëm-në-Kosovë-2017.pdf \(niph-rks.org\), qershor 2017;](#)
- 8) [Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike \(2023\). Raporti Vjetor i Departamentit të Ekologjisë Humane për vitin 2022. shkurt 2023.](#)



**Funded by  
the European Union**

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e projektit “Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër”, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Let’s Do It Peja.

Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

**Let’s Do It Peja**

Address: Shtëpia e Kulturës, kati III

30000, Pejë, Kosovë

Email: [letsdoitpeja@gmail.com](mailto:letsdoitpeja@gmail.com)

Tel: +383 49 124 548

[www.puacw.ldip.com](http://www.puacw.ldip.com)



Promoting Universal  
Access to **Clean Water**



# Siguria e Ujit të Pijshëm në Kosovë

